



FLETORJA ZYRTARE E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 90

2003

Tetor

P E R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.703, datë 16.10.2003	Për miratimin në parim të Marrëveshjes së rishitjes së aksioneve të INSIG sh.a., ndërmjet Ministrisë së Financave, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).....	3931
Vendim i KM nr.704, datë 16.10.2003	Për miratimin në parim të Marrëveshjes së aksionarëve ndërmjet Ministrisë së Financave, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).....	3931
Vendim i KM nr.705, datë 16.10.2003	Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankes Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për blerjen e aksioneve të INSIG sh.a.....	3932
Vendim i KM nr.706, datë 16.10.2003	Për miratimin e strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë dhe të sanitetit.....	3932
Vendim i KM nr.707, datë 16.10.2003	Për riorganizimin e drejtorive arsimore të rretheve në drejtori arsimore rajonale dhe në zyra arsimore	3933
Vendim i KM nr.708, datë 16.10.2003	Për mënyrën e licencimit dhe të funksionimit të agjencive private të punesimit.....	3934

Mendim i pakices i vendimit nr.30, datë 23.10.2003 të GJK	3937
Ndreqje gabimi	3938

VENDIM
Nr.703, datë 16.10.2003

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË RISHITJES SË AKSIONEVE TË
INSIG SHA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCIVE, KORPORATËS FINANCIARE
NDËRKOMBËTARE (IFC) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (BERZH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr.8899, datë 20.5.2002 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG sh.a., me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të Marrëveshjes së rishitjes së aksioneve të INSIG sh.a., ndërmjet Ministrisë së Financave, në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.704, datë 16.10.2003

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË AKSIONARËVE NDËRMJET
MINISTRISË SË FINANCIVE, KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC)
DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr.8899, datë 20.5.2002 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG sh.a., me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të Marrëveshjes së aksionarëve ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.705, datë 16.10.2003

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCIVE, KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC) DHE BANKËS
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR BLERJEN E AKSIONEVE
TË INSIG SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr.8899, datë 20.5.2002 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG sh.a., me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave, si pronare e aksioneve të INSIG, sh.a., që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për blerjen e aksioneve të INSIG sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.706, datë 16.10.2003

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË
SANITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë dhe të sanitetit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.707, datë 16.10.2003

PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORIVE ARSIMORE TË RRETHEVE NË DREJTORI ARSIMORE RAJONALE DHE NË ZYRA ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për arsimin parauniversitar" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8993, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Riorganizimin e drejtorive arsimore të rretheve në drejtori arsimore rajonale dhe në zyra arsimore.

2. Drejtoritë arsimore rajonale të funksionojnë në çdo qark. Ato janë person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

3. Drejtoria arsimore rajonale është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së shërbimit arsimor, në nivel qarku dhe kryen këto funksione kryesore:

a) Harton politikat e zhvillimit në fushën e arsimit parauniversitar, në nivel qarku, duke marrë parasysh veçoritë demografike të terrenit, të klimës, të zhvillimit ekonomik dhe të infrastrukturës vendore;

b) Realizon politikat rajonale në përputhje dhe në zbatim të strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit;

c) Harton dhe zbaton projekte me karakter vendor ose kombëtar, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe;

ç) Organizon inspektive në institucionet arsimore, publike dhe jopublike duke realizuar vlerësimin real të cilësisë së shërbimit të ofruar;

d) Organizon dhe realizon trajnimin dhe kualifikimin e personelit mësimdhënës të shkollave që ka në varësi, duke bashkëpunuar me institucionet e specializuara.

4. Zyrat arsimore të funksionojnë në çdo rreth, që nuk shërben si qendër qarku. Ato janë në varësi të drejtorive arsimore rajonale. Në çdo rreth, që shërben si qendër qarku, zyra arsimore të jetë pjesë përbërëse e strukturës së drejtorisë arsimore rajonale.

5) Zyra arsimore ka këto funksione kryesore:

a) Trajton problemet e burimeve njerëzore, emërimet dhe lëvizjet e stafit mësimor e drejtues, zhvillimin e karrierës etj;

b) Realizon këshillimin pedagogjik e psikologjik;

c) Mbledh të dhëna statistikore për shkollat në varësi, sipas kërkesave të drejtorisë arsimore rajonale dhe institucioneve qendrore;

ç) Angazhohet për forcimin e marrëdhënive mësues-nxënës-komunitet dhe për ndjekjen e veprimtarive kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare;

d) Menaxhon burimet financiare, investimet, shpenzimet e tjera për mjete didaktike etj.;

dh) Administron të gjithë procesin mësimor, në të gjitha elementet e tij dhe propozon ndryshime e përmirësime të kurrikulës.

6. Për qarkun e Tiranës të ketë dy drejtori arsimore rajonale, nga të cilat njëra të mbulojë rrethin e Tiranës dhe atë të Kavajës, kurse drejtoria tjetër të mbulojë vetëm qytetin e Tiranës.

7. Strukturat dhe organikat e drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

8. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës miraton rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore.

9. Drejtuesi i drejtorisë arsimore rajonale emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

10. Drejtuesi i zyrës arsimore emërohet ose largohet nga detyra nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale, që ka në varësi zyrën, ndërsa nëpunësit (përgjegjës sektori, specialistë) të këtyre drejtorive e zyrave nga drejtuesit përkatës. Emërimi i tyre bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Kur zyra arsimore është pjesë përbërëse e drejtorisë arsimore rajonale, atëherë drejtues përkatës të jetë drejtuesi i kësaj drejtorie.

11. Për punonjësit, që pas riorganizimit të drejtorive arsimore të rretheve, rezultojnë pa vend pune të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

13. Vendimi nr.418, datë 23.9.1992 i Këshillit të Ministrave "Për ngritjen dhe funksionimin e drejtorive arsimore të rretheve, si dhe për emërtetat dhe procedurat e lëvizjeve e të emërimit të kuadrit arsimor" dhe udhëzimi nr.2, datë 11.7.1994 i Këshillit të Ministrave "Për kompetencat dhe detyrat e drejtorive arsimore në rrethe", i ndryshuar, shfuqizohen.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.708. datë 16.10.2003

PËR MËNYRËN E LICENCIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCIVE PRIVATE TË PUNËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimtaria private e ndërmjetësimit në punë të ushtrohet vetëm nga agjencitë private të punësimit (në vazhdim agjencia), të licencuara pas përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Agjencia private e punësimit regjistrohet si person fizik/juridik, privat dhe e ushtron veprimtarinë e ndërmjetësimit në punë nëpërmjet këtyre shërbimeve:

a) informimit, këshillimit, si dhe vlerësimit të kërkesave dhe të aplikimeve për ndërmjetësimin për punë;

b) kërkimit të vendeve të punës;

c) ndërmjetësimit për përcaktimin e kushteve dhe lidhjen e marrëdhënieve të punës, ndërmjet punëkërkuesit dhe punëdhënësit.

3. Për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit, agjencia zbaton të gjitha marrëveshjet dypalëshe të Qeverisë shqiptare me vendet përkatëse.

4. Shërbimet e agjencisë për punëkërkuesit janë falas. Agjencia nuk e ngarkon punëkërkuesin me asnjë detyrim financiar, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me përjashtim të pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative të çdo punëkërkuesi.

5. Shpenzimet për shërbimin e ndërmjetësimit, të kryera nga agjencia, të përballohen nga pala punëdhënëse.

6. Agjencia siguron trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuesit. Asnjë punëkërkues nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a

filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, shoqërore ose përkatësia prindërore.

7. Punëkërkuksi i ndërmjetësuar në punë nga agjencia gëzon të drejtën për negocimin kolektiv, pagën minimale, kohën dhe kushtet e punës, përfitimet e sigurimeve shoqërore, mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit në punë.

8. Agjencia duhet të njoftojë punëkërkuksin për kushtet e punës dhe të punësimit, përpara fillimit të marrëdhënieve të punës.

9. Agjencia nuk duhet të ndërmjetësojë për punëkërkuksin në vende pune, që paraqesin rrezik e pasiguri për jetën dhe shëndetin e tij ose ku mund të jetë subjekt abuzimi a trajtimi diskriminues.

10. Personeli i agjencisë, për shërbimet që ofron, duhet të ketë kualifikimin dhe trajnimin e nevojshëm.

11. Agjencia bashkëpunon me zyrat shtetërore të punësimit për:

a) mbledhjen, shkëmbimin e të dhënave dhe përdorimin e terminologjisë së përbashkët për përmirësimin e transparencës së funksionimit të tregut të punës;

b) shkëmbimin e njoftimeve për vendet e lira të punës;

c) lidhjen e marrëveshjeve për zbatimin e veprimtarive të ndryshme;

ç) trajnimin e stafit.

12. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale është autoriteti përgjegjës, i cili lëshon licencat për agjencitë private të punësimit.

13. Pranë Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale ngrihet dhe funksionon komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencimin e këtyre agjencive. Mënyra e funksionimit dhe përbërja e komisionit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

14. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten për licencim janë:

a) kërkesa me shkrim për ushtrimin e veprimtarisë;

b) vendimi i gjykatës për regjistrimin si person fizik/juridik;

c) vërtetimi nga banka, deri në marrjen e licencës, për gjendje të ngurtësuar, në llogari rrjedhëse të shumës jo më pak se 100 000 (njëqind mijë) lekë të subjektit kërkuar;

ç) vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve fiskale e të sigurimeve shoqërore për tre muajt e fundit;

d) vërtetimi nga gjykata dhe prokuroria, i cili vërteton se kërkuksi i licencës nuk është në ndjekje penale;

dh) vërtetimi nga gjykata, i cili vërteton se subjekti fizik/juridik nuk është në proces falimentimi;

e) vërtetimi i gjendjes gjyqësore të kërkuksit, ortakut, aksionarit dhe anëtarëve të organeve drejtuese të subjektit që ka kërkuar licencën;

ë) përshkrimi i hollësishëm i veprimtarisë që kërkon të kryejë;

f) planimetria e mjediseve të agjencisë dhe një listë emërore e personelit, që përfshihet në procesin e ndërmjetësimit, e shoqëruar me CV-të përkatëse;

g) fotokopja e noterizuar e dokumentit të identifikimit dhe 2 fotografi të kërkuksit/kërkuksve.

15. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë private të ndërmjetësimit në punë nuk i jepet subjektit kërkuar, në rast se personi fizik/juridik (ortaku, aksionari ose anëtari i organeve drejtuese të tij):

a) ka qenë i dënuar për vepra penale të kryera me dashje;

b) provohet se ka kërkuar tarifa nga punëkërkuksi për shërbimet e ofruara;

c) ka përpiluar ose me dijeni ka përdorur dokumente të rreme;

ç) është punonjës i sistemit të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe ka një funksion të tillë që paraqet konflikt interesi;

d) i është anuluar licenca për mosrespektim të dispozitave të këtij vendimi.

16. Para lëshimit të licencës, Inspektorati Shtetëror i Punës bën inspektimin e mjediseve, të pajisjeve dhe të dokumenteve që zotëron personi fizik/juridik.

17. Komisioni i licencimit, pasi bën vlerësimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e interesuara dhe nga Inspektorati Shtetëror i Punës, i propozon Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale miratimin ose refuzimin e dhënies së licencës.

18. Afati i marrjes së vendimit për licencimin ose jo të subjektit të interesuar është 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës.

19. Licenca jepet për një vit, me të drejtë ripërtëritjeje. Kur licenca merret për herë të parë paguhet një tarifë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh për personat fizikë dhe 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh për personat juridikë. Ripërtëritja është falas.

20. Kërkesa për ripërtëritjen e licencës duhet të bëhet 45 ditë para afatit të skadimit të vlefshmërisë së licencës. Përveç kërkesave të parashikuara në pikën 14 të këtij vendimi kërkohet edhe një raport me shkrim për veprimtarinë e agjencisë.

21. Përpunimi i të dhënave të punëkërkuësit nga agjencia bëhet duke respektuar konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave, sipas natyrës së punës.

22. Agjencia nuk duhet të regjistrojë në dosje ose regjistra, të dhëna vetjake të punëkërkuësit, që nuk janë të nevojshme për të vlerësuar prirjen e tij për vendin e punës.

23. Agjencia duhet t'i ruajë të dhënat vetjake të një punëkërkuësi, vetëm për atë kohë sa justifikohet nga qëllimet e veçanta, për të cilat janë mbledhur këto të dhëna ose për atë kohë sa punëkërkuësi dëshiron të mbetet në listën e kandidatëve të mundshëm për një vend pune.

24. Agjencia, përveç rasteve kur lidhet drejtpërdrejt me kërkesat për një profesion të veçantë ose me pëlqimin e punëkërkuësit të interesuar, nuk duhet të kërkojë, të ruajë ose të përdorë të dhëna për gjendjen mjekësore të një punëkërkuësi ose të përdorë një të dhënë të tillë për përcaktimin e përshtatshmërisë së tij për punësim.

25. Agjencia, dy herë në vit, njofton Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale për strukturën dhe veprimtarinë e vet.

26. Inspektorati Shtetëror i Punës kryen inspektime periodike për të përcaktuar përputhshmërinë e veprimtarisë së agjencisë me legjislacionin përkatës dhe, kur vëren shkelje, njofton komisionin e licencimit.

27. Anulimi i licencës bëhet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale në rastet kur agjencia:

- a) ka shkelur parimin e barazisë, duke diskriminuar punëkërkuësit;
- b) pranon drejtpërdrejt ose tërthorazi pagesa, mallra ose shërbime nga punëkërkuësi, përveç pagesës së parashikuar në pikën 4 të këtij vendimi;
- c) reklamon njoftime të rreme ose mashtruese për ndërmjetësimin;
- ç) bën deklarata, dëshmi të rreme ose përdor dokumente të falsifikuara;
- d) nxit drejtpërdrejt ose tërthorazi punëkërkuësin për t'u transferuar në një vend tjetër pune, përveç kur ky transferim është në interes të punëkërkuësit;
- dh) ndikon ose përpiket të ndikojë çdo punëdhënëse ose ndërmarrje për të mospunësuar disa persona;
- e) ofron shërbimet e veta për të miturit;
- ë) angazhohet të ndërmjetësojë për punëkërkuësin në vende pune, që cenojnë dinjitetin e Republikës së Shqipërisë;
- f) pengon ose përpiket të pengojë inspektimin e organeve përkatëse;
- g) nuk përmbush detyrimet për sigurimet shoqërore ose kontratat e punës për punëmarrësin e vet.

28. Ankimi kundër vendimit për refuzimin e dhënies së licencës dhe për anulimin e saj bëhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

29. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda një muaji nga data e depozitimit të ankimit. Në rast se ankimi nuk zgjidhet brenda këtij afati, personi fizik/juridik mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të shqyrtimit të ankimit.

30. Vendimet nr.71, datë 11.2.1999 "Për mënyrën e licencimit dhe të funksionimit të agjencive private të punësimit" dhe nr.72, datë 11.2.1999 "Për mënyrën e licencimit dhe funksionimin e zyrave private të emigracionit" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

31. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS I
VENDIMIT NR.30, DATË 23.10.2003 I GJYKATËS KUSHTETUESE
(BOTUAR NË FLETOREN ZYRTARE NR.89)

Nuk jemi dakord me konkluzionet e shumicës. Mendojmë se vendimi nr.348, datë 18.2.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe si i tillë duhej të shfuqizohej nga Gjykata Kushtetuese.

Pretendimi kryesor pranë Gjykatës Kushtetuese i kërkueses, ka qenë mosrespektimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i të drejtës së saj për t'u mbrojtur me avokat, duke u vendosur kështu në kushte të pabarabarta gjykimi. Ne mendojmë se nga materialet e dosjes ky pretendim provohet plotësisht.

Përmes jurisprudencës së pasur të saj, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve në kuptimin kushtetues janë elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Mbi këtë bazë është theksuar se gjykatave të të gjitha niveleve u dalin një sërë detyrash, në mënyrë që brenda kuadrit ligjor ekzistues dhe mundësive të garantojnë sa më mirë parimin e barazisë së armëve dhe të mbrojtjes efektive të palëve në gjykim. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese ka evidentuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e veçantë të mbrojtjes me avokat në gjykimet që zhvillohen në Gjykatën e Lartë. Çështjet që trajtohen aty kanë natyrë të mirëfilltë ligjore, prandaj të drejtat dhe liritë e shtetasve pranë kësaj gjykate mund të mbrohen me efektivitet dhe profesionalizëm vetëm përmes avokatit që përfaqëson palët.

Rezulton e provuar se ditën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuesja është paraqitur vetë dhe i ka kërkuar që në fillim të seancës, Kolegjit Civil të kësaj gjykate, shtyrjen e gjykimit të çështjes me arsyetimin se avokati i caktuar prej saj ishte i sëmurë, gjë që vërtetohet edhe nga raporti mjekësor që përmban dosja. Pra, përderisa nuk mund të provohet e kundërta, duhet pranuar se ajo i kishte marrë masat për t'u përfaqësuar me avokat ditën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, por sigurisht, nuk mund të parashikonte që pikërisht këtë ditë, avokati i saj do të ishte i sëmurë.

Në vendim nuk përmenden një sërë faktesh të tjera që ka dosja dhe që u parashtruan në seancën gjyqësore që u zhvillua në Gjykatën Kushtetuese, të cilat, pavarësisht nga besueshmëria që paraqesin, përderisa nuk mund të rrëzohen, duhej të llogariteshin në favor të kërkesës. Kështu, u paraqit një prokurë përmes së cilës vërtetohet se rreth një javë para gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuesja ka caktuar si përfaqësues të saj ligjor pikërisht avokatin e deklaruar si mbrojtës të saj në seancën e zhvilluar pranë kësaj gjykate. Mosparaqitja e kësaj prokure, së bashku me rekursin, u justifikua me praktikën që zbatojnë normalisht gjykatat e të gjitha niveleve, që do të thotë se ajo paraqitet dhe verifikohet ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Për më tepër, avokati i kërkueses theksoi në seancën e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë ishte hartuar nga vetë ai, pavarësisht se përmbante vetëm nënshkrimin e klientes së tij.

Duke qenë kështu, mendojmë se konkluzioni i shumicës se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet e veta me shpalljen e listës dhe të datës së gjykimit të çështjes dhe kërkuesja duhej të merrte vetë masat në kohën e duhur për të caktuar avokatin që të përgatiste një mbrojtje efektive, nuk është i bazuar.

Për sa më sipër, mendojmë se në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkueses i është mohuar dukshëm e drejta e mbrojtjes. Në këtë gjykim ajo është vënë në pozitë krejt të pabarabartë me palën tjetër.

Anëtarë: K. Peçi, A. Karamuço, Xh. Zaganjori. Kryetar: F. Abdiu

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr. 83- 2003 në ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", në nenin 2 pika 2:

Është

2. Dispozitat e këtij ligji përbëjnë detyrim

Duhet

2. Dispozitat e këtij ligji **nuk** përbëjnë detyrim...

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TE AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PERMBLEDHESE NE FUSHEN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURES CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURES PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNES	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PERMBLEDHESE E LEGJISLACIONIT NE FUSHEN E PERMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TE KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi me 31.10.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë